



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2022

PROJEKTLIGJ*

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9774, DATË 12.7.2007
“PËR VLERËSIMIN DHE ADMINISTRIMIN E ZHURMËS NË MJEDIS”, I
NDRYSHUAR¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Kudo në tekstin e këtij ligji termi:

1. “Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve” zëvendësohet me “Agjencia Kombëtare e Mjedisit”
2. “bashki/komunë” dhe “bashkisë/komunës” zëvendësohet respektivisht me “bashki” dhe “bashkisë”;
3. “Organi/t/n/organet/njësia e qeverisjes vendore” zëvendësohet respektivisht me “bashki/ bashkia/bashkitë/bashkinë”

Neni 2

Në nenin 2, pika 2 pas fjalës “..miratojnë” shtohen fjalët “orarin dhe..”.

Neni 3

¹ Ky ligj përaftron plotësisht Direktivën 2002/49/EC të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 qershor 2002 në lidhje me vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore - Deklarata e Komisionit në Komitetin e Pajtimit mbi Direktivën në lidhje me vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore, Fletorja Zyrtare L 189, 18/07/2002 F. 0012 – 0026, 02002L0049 — EN — 29.07.2021 — 006.001

Në nenin 3, pas pikës 19, shtohen pikat me përmbajtje si më poshtë:

“20. “Aglomerat” është pjesa e një territori, me numër popullsie më të madhe se njëqindmijë banorë dhe dendësi popullsie prej më shumë se 3 000 banorë/km²

21. “Zonë turistike” është zona me vlerë natyrore të peizazhit, historike, kulturore, sportive, shëndetësore dhe pushimi, e përcaktuar sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi.

22. “Vërtetim” është dokumenti që lëshohet nga bashkia për plotësimin e kushteve për lëshuesit të zhurmës, sipas përcaktimit të nenit 11 të këtij ligji dhe në përputhje me nivelin e lejuar të zhurmës në mjedis të përcaktuar në aktet ligjore e nëligjore në fuqi.

Neni 4

Në nenin 5, pikat 1 dhe 2 ndryshojnë si më poshtë:

“1. Ministria është organi qendror përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit nga zhurma dhe për përcaktimin e niveleve kufi, si dhe nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit vlerësimin e ndikimit të zhurmës në mjedis.

2. Ministria që mbulon shëndetësinë është organi qendror përgjegjës për mbrojtjen e shëndetit nga ndikimet negative të zhurmës dhe vlerësimin e tyre në shëndetin e njeriut, nëpërmjet sektorit të zhurmave në Institutin e Shëndetit Publik”.

Neni 5

Nenet 6, 7, 22 dhe 23 shfuqizohen.

Neni 6

Neni 8 ndryshon si më poshtë:

“Neni 8 Bashkia

Bashkia është përgjegjëse për marrjen e masave për mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit, nga veprimtaritë ekonomike apo sociale që gjenerojnë zhurma brenda juridiksionit të saj, nëpërmjet:

- a) hartimit dhe zbatimit të planeve vendore të veprimit për zhurmën, të cilat miratohen nga këshilli i bashkisë;
- b) hartëzimit të zhurmës;
- c) shpalljes së zonave të qeta, në një mjedis të banuar apo në një mjedis të hapur, si dhe vendosin kufizime të tjera për zhurmën, në përputhje me nivelet e lejuara të zhurmave në mjedis dhe planin vendor të veprimit;
- ç) lëshimit të vërtetimit;
- d) kontrollit me pajisje të çertifikuara për matjen e niveleve të zhurmës, të personave fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari që gjenerojnë zhurmë;
- e) kontrollit, matjes, pezullimit apo mbylljes së veprimtarive, që nuk respektojnë dispozitat e këtij ligji”;

Neni 7

Në nenin 9, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç”, me përmbajtje si më poshtë:

“ç) oraret për ushtrimin e veprimtarive ekonomike, industriale, sociale, kulturore, argëtuese”.

Neni 8

Në nenin 12, bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshon si më poshtë:

“Leja e mjedisit dhe vërtetimi”

2. Pika 2 ndryshon si më poshtë:

“2. Personat fizikë dhe juridikë, që nuk përfshihen në pikën 1 të këtij neni, veprimtaritë e të cilëve lëshojnë zhurmë në mjedis, pajisjen me vërtetim nga bashkia, mbi plotësimin e kushteve për lëshuesit të zhurmës, sipas përcaktimit të nenit 11 të këtij ligji brenda niveleve të lejuara”.

3. Pas pikës 2, shtohet pika 3 me përmbajtje si më poshtë:

“3. Personat fizikë dhe juridikë të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, plotësojnë këkesat e këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi për nivelin e zhurmës.”

Neni 9

Në nenin 18, pika 4 ndryshon si më poshtë:

“4. Ushtrimi i veprimtarisë pa u pajisur me vërtetimin e parashikuar në pikën 2, të nenit 12, të këtij ligji”.

Neni 10

Në nenin 20, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 4 ndryshon si më poshtë:

“4. Bashkia, një vit pas hartëzimit të zhurmës dhe përgatitjes së hartave strategjike të zhurmës, pa u kushtëzuar, harton planin vendore të veprimit, duke mbajtur në konsideratë Planin e Përgjithshëm Vendor, kur:

- a. brenda territorit të tyre kanë nën administrim të paktën një aglomerat.
- b. brenda territorit të tyre ndodhen zona turistike;
- c. gjenden në afërsi të:
 - i. një rrugë kryesore rajonale, kombëtare ose ndërkombëtare, në të cilën ka më shumë se tre milion lëvizje automjesh në vit,
 - ii. një hekurudhe kryesore, në të cilën ka tridhjetëmijë lëvizje trenash në vit;
 - iii. një aeroport kryesor civil, në të cilin ka më shumë se pesëdhjetëmijë lëvizje në vit (lëvizje është një ngritje ose një ulje), duke përfshirë lëvizjet për qëllime të trajnimit të avionëve të lehtë .

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5, 6 dhe 7 me përmbajtje si më poshtë:

“5. Plani i veprimit për menaxhimin e zhurmave miratohet nga këshilli bashkiak dhe rishikohet çdo 5 vite nga data e miratimit të tij.

6. Gjatë hartimit të planeve të veprimit për menaxhimin e zhurmës, bashkia konsultohet me publikun, referuar përcaktimeve ligjore në fuqi për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin.

7. Çdo bashki raporton në ministri brenda muajit shtator të çdo viti, për zbatimin e planit të veprimit”.

Neni 11

Në nenin 21, pika 2 ndryshon si vijon:

“2. Bashkia publikon hartën strategjike, e cila është e aksesueshme për publikun, duke siguruar që informacioni mbi zhurmën mjedisore dhe efektet e saj të vihet në dispozicion të publikut”.

Neni 12

Në pikën 3 të nenit 24 fjalët “...realizohet nga ekspertë të certifikuar dhe...” hiqen.

Neni 13

Në nenin 25, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshon si mëposhtë:

“1. Matjet për nivelin e zhurmës për instalimet e pajisura me leje mjedisi kryhen nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ndërsa matjet për nivelin e zhurmës për aktivitetet e pajisura me vërtetim sipas pikës 2 të nenit 12, kryhen nga bashkia”.

2. Pika 3 shfuqizohet.

Neni 14

Në shkronjë “a” të nenit 28, pas fjlëve “...me leje mjedisore”, shtohen fjalët “... ose me vërtetimin sipas nenit 12, pika 2 e këtij ligji;”.

Neni 15

Pika 1 e nenit 29, ndryshon më përmbajtjen si vijon:

“1 Kontrolli i zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe i akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij, kryhet nga struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit, struktura përgjegjëse në bashki dhe struktura përgjegjëse për kontrollin e automjeteve”.

Neni 16

Në pikën 1 të nenit 32, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “a” ndryshon si më poshtë:

“a) ushtrimi pa leje mjedisore i veprimtarive që kanë detyrim të pajisen me leje mjedisi dhe që lëshojnë zhurmë mbi nivelin kufi të lejuar nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë;

2. Pas shkronjës “a” shtohet shkronja “a/1”, me këtë përmbajtje:

“a/1) ushtrimi pa vërtetimin sipas pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji i veprimtarive që kanë detyrim të pajisen me vërtetim dhe që lëshojnë zhurmë mbi nivelin kufi të lejuar , nga 200 000 lekë deri në 400 000 lekë;

3. Shkronjat “c”, “ç”, “d”, dhe “e” ndryshojnë si më poshtë:

- “c) lëshimi i zhurmës në mjedise të qeta, të shpallura të tilla me akt nënligjor të organeve të qeverisjes qendrore apo të vetqeverisjes vendore, nga 10 000 lekë deri në 50 000 lekë;
 - ç) refuzimi ose moslejimi i grupit të kontrollit për të kryer matjet, nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë;
 - d) fillimi i punës ose i veprimtarisë, pa zbatuar masat e mbrojtjes nga zhurma, që kërkohen në lejen mjedisore apo vërtetimin për zhvillimin e aktivitetit që lëshon zhurmë, nga 100 000 lekë deri në 300 000 lekë;
- shfuqizohet.
- e) instalimi dhe vënia në punë e makinerive dhe impianteve në mjedise të brendshme apo të jashtme, pa zbatuar masa mbrojtëse, zhurma e të cilave kapërcen nivelin kufi, nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë;

4. Shkronja “dh” shfuqizohet.

5. Pas pikë 2, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Gjoha e vendosur për kundravajtjet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni përbën titull ekzekutiv dhe paguhet brenda periudhës së përcaktuar në nenin 30 të ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Neni 17

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

LINDITA NIKOLLA